



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1591/2 prot.

Datë 03.09.2021

**V E N D I M**  
**Nr. 573/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2021 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër*”, me Nr. REF-01135-07-16-2021, me objekt: “*Shërbimi mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*”, me fond limit 8.000.000 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 06.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Sark” SHPK  
Lagjja “8 Shkurti”, Rruga “Skënderbeu”, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë  
Sheshi “4 Heronjtë”, Rr. “Osman Haxhiu”, Vlorë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 24 e vijues Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, pasi ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka mangësi, pasi nuk është sipas formularit përkatës si dhe nuk është dorëzuar mandatpagesa, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.07.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-01135-07-16-2021, me objekt: “Shërbimi mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”, me fond limit 8.000.000 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 06.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 06.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.08.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “K & N” SHPK 7.936.312,75 lekë, kualifikuar
2. “Sark” SHPK 7.324.210 lekë, skualifikuar

II.4. Në datën 16.08.2021, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe në datë 23.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletin Nr.125 datë 23.08.2021, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “K & N” SHPK.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 12.08.2021 operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kjo e fundit nuk është paraqitur sipas formularit standart të ankesës si dhe i mungon dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.7. Duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK shfaq mangësi, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr.1482/3 prot., datë 20.08.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë, informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ky autoritet, për sa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK.

II.8. Në datë 23.08.2021, autoriteti kontraktor, informon me anë të emailit të dërguar në adresën zyrtare të KPP (info@kpp.gov.al), se: “*Ne lidhje me veprimet administrative të kryera për këtë procedurë ju sqarojmë si më poshtë:*

*Ne date 06.08.2021 është kryer hapja e ofertave prej anetareve të KVO dhe ne date 09.08.2021 është perfunduar vlerësimi i tyre duke i dërguar edhe mesazhin përkatës operatorëve ofertues.*

*Sqarojmë se pas dates 10.08.2021, një pjesë e stafit të Bashkisë Vlore (duke përfshirë edhe stafin që ka qenë pjesë e kësaj procedure prokurimi) kanë filluar lejen e zakonshme.*

*Ne date 16.08.2021 është ngarkuar në sistem njoftimi i fituesit për efekt të fillimit të afatëve të ankimimit i cili është publikuar në SPE ne date 17.08.2021.*

*Ne lidhje me procedurën e ankimimit sqarojmë se operatori ekonomik Sark ka paraqitur një ankesë në SPE ne date 11.08.2021, si dhe kjo ankesë është administruar në protokollin e Bashkisë Vlore ne date 12.08.2021.*

*Ndodhur në kushtet kur sikurse ju kemi sqaruar edhe për sa më lart, që një pjesë e stafit kanë qenë me leje të zakonshme (por edhe për faktin se titullari AK ka patur probleme shëndetësore), por edhe për shkak se kjo ankesë është paraqitur pa filluar afati i ankimimit, prej Bashkisë Vlore, nuk është kryer ndonjë veprim konkret.*

*Bazuar ne publikimin ne kohe reale te ankesave ne faqen e KPP kemi konstatuar se nuk eshte kryer pagesa e tarifes se ankimit prej subjektit ankimues, por dhe bazuar ne shkresen tuaj konstatojme se pervec kesaj, nuk eshte paraqitur ankimi ne formen e kerkuar.*

*Po ju dergojme kete email, per efekt te informimit, por sikurse kemi sqaruar edhe me siper na nevojitet me shume dite per kthimin e pergjigjes shkresore, per dergimin e informacionit te nevojshem apo kryerjen e cdo veprimi tjetër ne lidhje me kete procedure”.*

II.9. Me anë të shkresës nr.1591 prot., datë 25.08.2021 Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar përsëri autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë, informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ky autoritet, për sa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr.12076/1 prot datë 30.08.2021 protokolluar me tonën me nr.1591/1 prot., datë 02.09.2021 me objekt “Kthim-përgjigje kërkesës për informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera informon: “[...]Ne date 06.08.2021 është kryer hapja e ofertave prej anëtarëve të KVO dhe në datë 09.08.2021 është përfunduar vlerësimi i tyre duke i dërguar edhe mesazhin përkatës operatorëve ofertues. Sqarojmë se pas datës 10.08.2021, një pjesë e stafit të Bashkisë Vlorë (duke përfshirë edhe stafin që kanë qenë pjesë e kësaj procedure prokurimi) kanë filluar lejen e zakonshme.

*Ne date 16.08.2021 është ngarkuar në sistem njoftimi i fituesit per efekt te fillimit te afateve të ankimit i cili është publikuar në SPE në datë 17.08.2021.*

*Ne lidhje me procedurën e ankimit sqarojmë se operatori ekonomik Sark ka paraqitur nje ankese ne SPE ne date 11.08.2021, si dhe kjo ankese eshte administruar ne protokollin e Bashkise Vlore ne date 12.08.2021.*

*Paraqitja e kësaj ankese jo në përputhje me afatet e nenit 97 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (pasi afati ka filluar pas datës 17.08.2021) ka krijuar një situatë ku autoriteti kontraktor duhet të shqyrtojë një ankesë, kur në fakt bazuar në dispozitat nënligjore kjo ankesë është paraqitur pa lindur ende e drejta e ankimit.*

*Bazuar në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik është konstatuar se nuk është paraqitur mandati i pagesës së tarifës së ankimit prej subjektit ankimues, por edhe bazuar në shkresën tuaj nr.1482/3 prot., datë 20.08.2021, konfirmohet se edhe ankimi nuk është paraqitur në formën e kërkuar.*

*Ndodhur në kushtet kur sikurse është sqaruar edhe më lart, që një pjesë e stafit kanë qenë me leje të zakonshme (por edhe për faktin se titullari AK ka patur probleme shëndetësore), por edhe për shkaqet e sipërpërmendura në lidhje me afatet e lindjes së drejtës së ankimit, prej Bashkisë Vlorë nuk është kryer ndonjë veprim konkret, për shqyrtimin e ankesës. Nga sa më lart, edhe pse ndodhur përpara këtyre rrethanave në datë 30.08.2021, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë është kryer pezullimi i procedurës së prokurimit, si dhe është caktuar personi përgjegjës që do të shqyrtojë ankesën e paraqitur (bashkëlidhur kopje e urdhrit). Njëkohësisht në zbatim të nenit 111/3 të LPP-së, ankimuesit i është dërguar një email në adresën zyrtare sipas QKB, ku i është kërkuar konfirmimi/sqarimi për elementët që i mungojnë (mungesa e mandat pagesës, formulari i ankesës në KPP sipas modelit standard, si dhe nëse është paraqitur ankesë tjetër në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj). Bashkia*

*Vlorë në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, kreu XIV, do të gjykojë nëse do të marrë në shqyrtim këtë ankesë, pas marrjes së sqarimeve të mësipërme, si dhe do ju informojë mbi veprimet e kryera”.*

Gjithashtu, autoriteti kontraktor bashkëlidhur informacionit të mësipërm ka paraqitur, shkresën nr. 12165 prot., datë 30.08.2021 “*Urdhër i brendshëm Nr.207 dt. 30.08.2021*”, me anë të të cilit ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe kërkesën për informacion dërguar me anë të emailit operatorit ekonomik “Sark” ShPK, në datë 30.08.2021, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik plotësimin e dokumentacionit si më poshtë: “*Nga verifikimi i kësaj ankese rezulton se nuk është bashkëlidhur mandati i pagesës së tarifës së ankimit, fakt ky i konfirmuar edhe nga baza e të dhënave në Komisionin e Prokurimit Publik. Nga korrespondenca me këtë institucion, rezulton që jo vetëm që nuk keni paraqitur kopje të mandatit të pagesës, por edhe nuk keni paraqitur ankesën sipas modelit standard të miratuar nga APP. Bashkia Vlorë kërkon nga ana juaj si më poshtë: - të dërgoni kopjen e mandat pagesës së tarifës së ankimit të kryer në momentin e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe në KPP; – të konfirmoni nëse ankesa pranë KPP është kryer sipas modelit standard të miratuar prej APP; - të konfirmoni nëse keni paraqitur ankesë tjetër pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së, në përputhje me afatet e ankimit sipas nenit 97 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.1.1. Në datën 19.07.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër*”, me Nr. REF-01135-07-16-2021, me objekt: “*Shërbimi mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë*”, me fond limit 8.000.000 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 06.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

III.1.2. Në datën 06.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.3. Në datën 09.08.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                 |                                |
|-----------------|--------------------------------|
| 1. “K & N” SHPK | 7.936.312,75 lekë, kualifikuar |
| 2. “Sark” SHPK  | 7.324.210 lekë, skualifikuar   |

III.1.4. Në datën 16.08.2021, është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe në datë 23.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletin Nr.125 datë 23.08.2021, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “K & N” SHPK.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 12.08.2021 operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se kjo e fundit nuk është paraqitur sipas formulari standart të ankesës si dhe i mungon dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.7. Duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Sark” SHPK shfaq të meta, Komisioni i Prokurimit Publik, me anë të shkresës nr.1482/3 prot., datë 20.08.2021, i ka kërkuar autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë, informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ky autoritet, për sa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK.

III.1.8. Në datë 23.08.2021, autoriteti kontraktor, informon me anë të emailit të dërguar në adresën zyrtare të KPP (info@kpp.gov.al), se: “Ne lidhje me veprimet administrative të kryera për këtë procedurë ju sqarojmë si më poshtë:

*Ne date 06.08.2021 është kryer hapja e ofertave prej anetareve të KVO dhe ne date 09.08.2021 është perfunduar vlerësimi i tyre duke i dërguar edhe mesazhin përkatës operatorëve ofertues.*

*Sqarojmë se pas dates 10.08.2021, një pjesë e stafit të Bashkisë Vlore (duke përfshirë edhe stafin që kanë qenë pjesë e kësaj procedure prokurimi) kanë filluar lejen e zakonshme.*

*Ne date 16.08.2021 është ngarkuar në sistem njoftimi i fituesit për efekt të fillimit të afatëve të ankimimit i cili është publikuar në SPE ne date 17.08.2021.*

*Ne lidhje me procedurën e ankimimit sqarojmë se operatori ekonomik Sark ka paraqitur një ankesë në SPE ne date 11.08.2021, si dhe kjo ankesë është administruar në protokollin e Bashkisë Vlore ne date 12.08.2021.*

*Ndodhur në kushtet kur sikurse ju kemi sqaruar edhe për sa më lart, që një pjesë e stafit kanë qenë me leje të zakonshme (por edhe për faktin se titullari AK ka patur probleme shëndetësore), por edhe për shkak se kjo ankesë është paraqitur pa filluar afati i ankimimit, prej Bashkisë Vlore nuk është kryer ndonjë veprim konkret.*

*Bazuar ne publikimin ne kohe reale te ankesave ne faqen e KPP kemi konstatuar se nuk eshte kryer pagesa e tarifes se ankimit prej subjektit ankimues, por dhe bazuar ne shkresen tuaj konstatojme se pervec kesaj, nuk eshte paraqitur ankimi ne formen e kerkuar.*

*Po ju dergojme kete email, per efekt te informimit, por sikurse kemi sqaruar edhe me siper na nevojitet me shume dite per kthimin e pergjigjes shkresore, per dergimin e informacionit te nevojshem apo kryerjen e cdo veprimi tjetër ne lidhje me kete procedure”.*

III.1.9. Me anë të shkresës nr.1591 prot., datë 25.08.2021 Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar përsëri autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë, informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ky autoritet, për sa i përket ankesës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK.

III.1.10. Nëpërmjet shkresës nr.12076/1 prot datë 30.08.2021 protokolluar me tonën me nr.1591/1 prot., datë 02.09.2021 me objekt “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku ndër të tjera informon: “[...]Ne date 06.08.2021 është kryer hapja e ofertave prej anëtarëve të KVO dhe në datë 09.08.2021 është përfunduar vlerësimi i tyre duke i dërguar edhe mesazhin përkatës operatorëve ofertues. Sqarojmë se pas datës 10.08.2021, një pjesë e stafit të Bashkisë Vlorë (duke përfshirë edhe stafin që kanë qenë pjesë e kësaj procedure prokurimi) kanë filluar lejen e zakonshme.

*Ne date 16.08.2021 është ngarkuar në sistem njoftimi i fituesit per efekt te fillimit te afateve të ankimit i cili është publikuar në SPE në datë 17.08.2021.*

*Ne lidhje me proceduren e ankimit sqarojme se operatori ekonomik Sark ka paraqitur nje ankese ne SPE ne date 11.08.2021, si dhe kjo ankese eshte administruar ne protokollin e Bashkise Vlore ne date 12.08.2021.*

*Paraqitja e kësaj ankese jo në përputhje me afatet e nenit 97 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (pasi afati ka filluar pas datës 17.08.2021) ka krijuar një situatë ku autoriteti kontraktor duhet të shqyrtojë një ankesë, kur në fakt bazuar në dispozitat nënligjore kjo ankesë është paraqitur pa lindur ende e drejta e ankimit.*

*Bazuar në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik është konstatuar se nuk është paraqitur mandati i pagesës së tarifës së ankimit prej subjektit ankimues, por edhe bazuar në shkresën tuaj nr.1482/3 prot., datë 20.08.2021, konfirmohet se edhe ankimi nuk është paraqitur në formën e kërkuar.*

*Ndodhur në kushtet kur sikurse është sqaruar edhe më lart, që një pjesë e stafit kanë qenë me leje të zakonshme (por edhe për faktin se titullari AK ka pasur probleme shëndetësore), por edhe për shkaqet e sipërpërmendura në lidhje me afatet e lindjes së drejtës së ankimit, prej Bashkisë Vlorë nuk është kryer ndonjë veprim konkret, për shqyrtimin e ankesës. Nga sa më lart, edhe pse ndodhur përpara këtyre rrethanave në datë 30.08.2021, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë është kryer pezullimi i procedurës së prokurimit, si dhe është caktuar personi përgjegjës që do të shqyrtojë ankesën e paraqitur (bashkëlidhur kopje e urdhrit). Njëkohësisht në zbatim të nenit 111/3 të LPP-së, ankimuesit i është dërguar një email në adresën zyrtare sipas QKB, ku i është kërkuar konfirmimi/sqarimi për elementët që i mungojnë (mungesa e mandat pagesës, formulari i ankesës në KPP sipas modelit standard, si dhe nëse është paraqitur ankesë tjetër në përputhje me afatet e përcaktuara në ligj). Bashkia*

Vlorë në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, kreu XIV, do të gjykojë nëse do të marrë në shqyrtim këtë ankesë, pas marrjes së sqarimeve të mësipërme, si dhe do ju informojë mbi veprimet e kryera”.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor bashkëlidhur informacionit të mësipërm ka paraqitur, shkresën nr. 12165 prot., datë 30.08.2021 “Urdhër i brendshëm Nr.207 dt. 30.08.2021”, me anë të të cilit ka urdhëruar pezullimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe kërkesën për informacion dërguar me anë të emailit operatorit ekonomik “Sark” ShPK, në datë 30.08.2021, ku ndër të tjera autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik ndreqjen e të metave të ankesës së tij.

III.1.11. Në nenin 111, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.12. Në nenin 33 “Formulari i ankesës”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

“Kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit dhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.”

Gjithashtu në nenin 94 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

“3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankimuesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë dhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet.



*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.*

*5. Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.*

*Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.*

*Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.*

*6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.*

III.1.13. Në dokumentet standarde të tenderit, në Seksionin IV parashikohet: “Seksioni IV përfshin formularët standard që përdoren nga operatorët ekonomikë, në procesin e ankimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe njoftimet që duhet të plotësohen nga autoriteti kontraktor në përfundim të procesit të prokurimit.” Gjithashtu në “Shtojcën 20” të dokumenteve standarde të tenderit është publikuar “Formulari i ankesës pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.14. Në pikën 2 gërma “a”, të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, është parashikuar se:

*“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

*a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;”*

III.1.15. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”

III.1.16. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.17. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati*

*mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.1.18. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.1.19. Në nenin 97 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

*“2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:*

*a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

*b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”*

III.1.20. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.*

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.*

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.*

*2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësismit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;
- d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.21. Së pari, nga shqyrtimi i ankesës së dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Sark” SHPK nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj, pasi nuk është paraqitur sipas formularit standard të ankesës të miratuar dhe të publikuar në dokumentet standarde të tenderit, si dhe nuk është dorëzuar bashkëlidhur mandatpagesa, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Theksojmë, se në zbatim të nenit 33 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit dhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

Gjithashtu, në Shtojcën 20 të dokumenteve standarde të tenderit pasqyrohet formulari standard i ankesës që operatorët ekonomikë mund të paraqesin pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me pretendimet e tyre.

Akoma më tej, nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

III.1.22. Nisur nga sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues “Sark” SHPK nuk ka respektuar formën e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik sipas kërkesave ligjore dhe atyre të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Aktet e prodhuara nga një person juridik privat, duhet të përmbajnë të gjitha elementet thelbësore, që i bejnë ato të vlefshme si nga ana formale dhe ajo materiale. Komisioni i Prokurimit Publik, në analizë të aktit Nr.14 prot., datë 11.08.2021 “Ankimim për procedurën me objekt “Shërbimi mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”, protokolluar pranë KPP me nr.1482 prot, datë 12.08.2021, i cili është i një rëndësie të veçantë në një procedurë prokurimi, gjykon se kjo ankesë nuk është plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit, dhe legjislacioni në fuqi, të cilat janë të detyrueshme të përmbushen nga ankimuesi, në të gjithë elementet që përmban ajo, përfshirë formën sipas formularit standard të miratuar si dhe pagesën e tarifës përkatëse për ankimin.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor nuk plotëson kushtet formale, siç është forma dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

III.1.23. Së dyti, referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, verifikimeve në Buletinin e Prokurimit Publik të publikuar nga APP, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor, u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimit Publik në datë 16.08.2021 dhe në datë 23.08.2021 është publikuar njoftimi i fituesit në Buletinin Nr.125 datë 23.08.2021, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “K & N” SHPK.

KPP vëren se operatori ekonomik ankimues “Sark” ShPK, ka dorëzuar ankesën (me të meta formale) pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik më datë 12.08.2021, ku kërkon shfuqizimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën 12.08.2021, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar akoma njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, në datën 12.08.2021, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar akoma për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se ankimuesit nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 12.08.2021, përveç mungesave formale si më sipër argumentuar, do të konsiderohet edhe e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj si dhe sipas të gjitha elementeve formale të domosdoshme.

III.1.24. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, përveç mospërmbushjes së kushteve formale si forma e paraqitjes së saj dhe pagesa e tarifës, nuk ka përmbushur gjithashtu dhe detyrimin për

ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i anës formale si dhe afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me vendimin e autoritetit kontraktor Nr.12165 prot., datë 30.08.2021 “*Urdhër i brendshëm Nr.207, dt.30.08.2021*”, me anë të së cilit ka vendosur pezullimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe kërkesës për informacion drejtuar operatorit ekonomik “Sark” SHPK në datë 30.08.2021, me anë të postës elektronike, për plotësimin e të metave të ankesës së paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale, atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave). Normativa e parashikuar nga nenet 110 dhe 111 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP, ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor nuk mund të bëhet vetiniciator i fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe që plotësojnë kushtet formale të ankesës, sic janë paraqitja e ankimit sipas formularit standard të miratuar, pagesa e tarifës përkatëse si dhe paraqitja e mandatit të pagesës bashkëlidhur ankesës së paraqitur njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, por dhe respektimi i afateve të ankimit. Pra, komisioni i shqyrtimit të ankesave në ansjë rast nuk duhet të marrë në shqyrtim një ankesë e cila është paraqitur në mungesë të kushteve formale dhe respektimit të afateve të ankimit. Për këtë arsye, Komisioni gjykon se vendimi i autoritetit kontraktor në datë 30.08.2021 për pezullimin e procedurës së prokurimit, deri në përgjigje të operatorit ekonomik për plotësimin e kushteve formale të ankesës, për sa kohë ankimi i operatorit ekonomik është dorëzuar para fillimit të afateve të ankimit sipas ligjit për prokurimin publik, janë në kundërshtim të plotë me aktet ligjore

dhe nënligjore në fuqi, ndaj këto vendime do të shpallen absolutisht të pavlefshme nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sark” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-01135-07-16-2021, me objekt: “Shërbimi mirëmbajtjes të varrezave publike dhe të dëshmorëve të Bashkisë Vlorë”, me fond limit 8.000.000 lekë pa TVSh, zhvilluar me datë 06.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**